



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA

REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E KAMENICËS - OPŠTINA KAMENICA KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z./S. 04	Nr./Br./No. 9789
Nr. ifaq. 2	Data: 15/04
Br. Str. 2	Date: 2026
No. Pg.	
KAMENICË - KAMENICA	



KOMUNA E KAMENICËS DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Kamenicë, duke u bazuar në nenin 11 pika 7 dhe nenin 12 pika 6 Statutit Sh.01 Nr.10370 të datës 03.04.2024 të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr.SHABAN GECI” në Kamenicë, me qëllim të themelimit të Këshillit të Pacientëve me datë **15.04.2026** e publikon këtë:

FTESË PUBLIKE

“PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË PACIENTËVE”

Me hyrjen në fuqi të Statutit të QKMF - së, përkatësisht nenin 12.6, është paraparë edhe themelimi i Këshillit të Pacientëve. Me qëllim të zbatimit të këtij neni, Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, fton të gjithë qytetarët e interesuar të aplikojnë për të qenë pjesë e këtij këshilli.

Këshilli i Pacientëve do të përbëhet nga 5 persona dhe do të ketë mandat 5 vjeçar.

Propozimet duhet të dorëzohen nga data **15.04.2026** deri me datë **30.04.2026** në e-mailin **besart.s.kryeziu@rks-gov.net**, ose në zyrën e Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Të gjitha propozimet e pranuar pas këtij afati, nuk do të merren parasysh nga komisioni.

Dokumentet e kërkuara:

1. Aplikacioni për të qenë anëtar i këshillit;
2. Kopja e Leternjoftimit;
3. Një leter motivuese pse dëshironi të jeni anëtar i këshillit.

Dr. Besart KRYEZIU

Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale





KOMUNA E KAMENICËS DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Termet e Referencës:

Në Statutin e Qendres Kryesore të Mjekësisë Familjare është paraparë edhe themelimi i **Këshillit të Pacientëve** si një mekanizëm formal i angazhimit të qytetarëve në kujdesin shëndetësor. Për këtë qëllim, DKSHMS ka hapur thirrje publike për të gjithë qytetarët e **Komunës së Kamenicës** që janë të interesuar të jenë pjesë e Këshillit të Pacientëve.

***Qëllimi** i Këshillit të Pacientëve është që të shërbej si një mekanizëm formal për përfshirjen e pacientëve në vendimarrje në mënyrë që të punojnë së bashku me institucionet dhe stafin shëndetësor për të rritur cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore për pacientët dhe komunitetin.*

Objektivat e Këshillit të Pacientëve do të jenë:

- Të përfshijë pacientët në vendimarrje lidhur me shërbimet shëndetësore;
- Të rrisë vetëdijen e qytetarëve për shëndetin dhe të drejtat e tyre;
- Të identifikojë problemet dhe nevojat e pacientëve;
- Të forcojë besimin dhe komunikimin ndërmjet pacientëve dhe stafit shëndetësor;
- Të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Fushëveprimi i këshillit të pacientëve shtrihet brenda teritorit të komunës së Kamenicës dhe merret me përfaqësimin e interesave dhe brengave të pacientëve brenda kësaj komune;

Antarësimi në Këshill të Pacientëve është i hapur. Të dretjë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Kamenicës të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare, nuk janë anëtar të ndonjë partie politike, të cilët nuk ofrojnë shërbime shëndetësore ose farmaceutike dhe nuk kanë të kaluar kriminale.